

Adresa : Rruga Urani Pano ap.c-07 kati 6 hyrja 10 Tirane Email:arifaj_shpk@yahoo.com Tel&Fax+35542228084

Nr prot.

Date 06/10/2016.

KONTRATE

(Ndertimi Palester Prane Shkolles Sabah Sinani dhe Migjeni Bashkia Puke)

E lidhur sot me date 06/10/2016, ne Tirane, ndermjet paleve kontraktuese:

"ARIFAJ" sh.p.k. me seli ne Tirane, "Rruga Urani Pano ap.c.07 kati 6 hyria 10 ", e regjistruar si person juridik prane Qendres Kombetare te Regjistrimit, me date 25.05.1998, me Nipt J76418907K, perfaqesuar ligjerisht nga Administratori Znj. Rezarta Bokciu, e dtl. 1978, lindur ne Kukës dhe banuese ne Tirane, me nr. Leternjoftimi ID 027691525, madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar, ketu e me poshte i quajtur "Kontraktori", dhe,

"Pepa Grup" sh.p.k. me nipt L42215009 L perfaqesuar nga administratori Z.Urim Pepa me seli ne Tirane Kasher " dhe nr.telefoni 0662090990 me poshte quajtur "Nenkontraktori",

Baza Ligjore : Neni 850 e vijim i Kodi Civil te Republikes se Shqiperise.

Neni 1. Prezantim i pergjithshem

ARIFAJ sh.p.k. ka lidhur kontrate me bashkine Puke dhe parashikon te beje punime te "Ndertimi palester prane shkolles Sabah Sinani dhe Migjeni Bashkia Puke (mur tulle,f.v. suvatime te brendeshme,f.v. shtresa te varfera dhe brez betoni me murature etj.) sipas projektit bashkelidhur.

Neni 2. Objekti i kontrates

2.1. Ne baze te kesaj kontrate, kontraktori kerkon te realizoje punimet sipas projektit bashkelidhur dhe nenkontraktori merr persiper realizimin e tyre si me poshte vijon:

2.2. Nenkontraktori eshte miratuar nga ana e bashkise Puke dhe eshte njohur me vendin, ka bere vleresimin dhe ka marre persiper te realizoje te gjitha punimet e nevojshme sipas cilesise dhe standarteve te percaktuara nga palet, ne perputhje te plote me kontraten baze lidhur nga shoqeria Arifaj sh.p.k. me bashkine Puke, projektin, preventivin dhe grafikun e punimeve.

Drejtues teknik punimesh per objektin e sipercituar caktohet ing. shoqerise Pepa Grup Alfred Çausi.

Neni 3. Dokumentat bashkelidhur

3.1. Dokumentat ne vazhdim jane pjese integrale e kontrates dhe plotesuese te njera-tjetres:

Kontrata baze e lidhur me bashkine Puke

- Preventivi i Punimeve (Shtojca Nr. 1);
- Projekti i Zbatimit (Shtojca Nr. 2);
- Certifikata Regjistrimi personit te tatushem.
- Liste pagesa e deklarimit te punonjesve te nenkontraktorit prane sigurime shoqerore dhe Tatimeve.

3.2. Ne rast kontradiktash ne permbajtje dhe interpretim, mbizoterojne kerkesat e kesaj kontrate



te cilat si kushte te vecanta, renditen ne krye te prioriteteve.

Neni 4. Cmimi i siper marrjes

4.1. Cmimi i kesaj kontrate eshte sipas listes se cmimeve preventivit te punimeve te kontrates baze te lidhur me bashkine Puke.(Shtojca Nr. 1dhe sipas matjeve faktike ne objekt).

Te gjitha cmimet sipas kesaj kontrate jane me TVSH.

4.2. Ne cmim perfshihen te gjitha shpenzimet e kryera per realizimin e objektit te kesaj kontrate, si edhe te gjitha shpenzimet qe jane te detyrueshme ne baze te ligjit ne kuadrin e kryerjes se kesaj siper marrjeje, si me poshte:

- Tatimet, taksat;
- Pagesat per sigurimet shoqerore, te parashikuara ne aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi;
- Pagat dhe honoraret e fuqise punetore.

4.3. Nuk perfshihen ne kete cmim:

- Vlera e shpenzimeve shtese te punimeve ne rastet e ndryshimeve ne projekt te kerkuara nga porositesi, ndryshime per te cilat siper marrjesi ka rene dakort me shkrim me porositesin.

Neni 5. Menyra e pageses

Likujdimi i punes se kryer do te do te behet ne baze te proceseve te punes te perfunduara ne fakt sipas situacioneve dhe faturave te konfirmuara nga ana e mbikqyresit te punimeve te objektit.

Neni 6. Afati i kryerjes se punimeve

6.1. Kohezgjatja e punimeve eshte vleresuar te jete sipas kontrates baze lidhur me bashkine Puke.

6.2. Nenkontraktori do te mbaje pergjegjesi ne shtyrjen e afatit perfundimtar ne rast se ai nuk ka sjelle ne kohe mjetet dhe punetoret e nevojshem dhe te kerkuar nga detyra qe ka mare persiper. Ne kete rast kontraktori duhet t'i beje per cdo rast njoftim me shkrim nenkontraktori, ne momentin e mungesave te siperpermendura.

6.3. Ne rast se kontraktori-do te beje ndryshime gjate zbatimit te projektit, koha e shpenzuar nga nenkontraktori per realizimin e ketyre ndryshimeve do te shtohet ne afatin e percaktuar ne nenin 6.4.

6.4. Kerkesa per ndryshime duhet te paraqitet me shkrim nga kontraktori dhe investitori.

6.5. Palet nuk pergjigjen per mospermbushjet teresore apo pjesore te detyrimeve qe rrjedhin nga kjo kontrate, nese kjo mospermbushje eshte pasoje e nje ngjarje te Forces Madhore. Force Madhore konsiderohet cdo rrethane e paparashikueshme dhe e pakontrollueshme nga vullneti i paleve dhe qe palet nuk kane patur mundesi ta parandalojne, rrethane e cila pengon permbushjen e detyrimeve kontraktore te marra persiper.

6.6. Konsiderohen raste te Forces Madhore, por pa u kufizuar vetem ne to: (i) lufta e shpallur apo jo, lufte civile, gjendje e jashtezakonshme, revolucione, akte terroriste a sabotazhi, shperthime nga lende eksplozive, zjarri e ngjarje te ngjajshme me to; (ii) fatkeqesi natyrore sic jane stuhite, ciklonet, termetet, e ngjarje te ngjajshme me to; (iii) bojkotet, grevat e ngjarje te ngjajshme me to (iv) kushte te veshtira klimaterike.

Neni 7. Te drejtat dhe detyrimet e nenkontraktorit

7.1. Nenkontraktori duhet te realizoje siper marrjen e perkufizuar ne Nenin 2 te kesaj kontrate, ne afat sipas nenit 6 dhe duke zbatuar projektin perkates.

7.3. Transporti do te realizohet me mjetet dhe shpenzimet e nenkontraktoriot.

7.4. Nenkontraktori mban pergjegjesi civile dhe penale per veprimet e pakujdesshme te punetoreve te tij, si edhe per sigurimin e punonjesve te tij kundrejt te gjitha aksidenteve,si dhe



REPUBLICA E KOSOVES
KOMUNA E PUKES
BASHKIA PUKË-Ë

ndaj paleve te treta ne baze te dispozitave ligjore ne fuqi.

7.5. Nenkontraktori do te plotesoje dhe veproje sipas te gjitha kerkesave te kontraktorit per kontrollin e cilesise dhe do te ndjeke udhezimet dhe urdherat e dhena nga perfaqesues te investitorit gjate kryerjes se siper marrjes. Te gjitha kerkesat per ndryshime ne porosi duhet te paraqiten me shkrim nga kontraktori dhe investitori.

7.6. Nenkontraktori nuk do te jete pergjegjes per vonesat rrjedhoje e vendimeve te gabuara te investitorit ose ne rast vonesash si shkak i ndonje modifikimi ose punimi shtese qe nuk jane objekt i kesaj kontrate.

7.7. Nenkontraktori merr persiper te realizoje te gjitha punimet ne lidhje me ndryshimet ne porosi qe kerkohen me ane te nje marreveshje me shkrim nga ana e investitorit dhe fillon realizimin e ndryshimeve sipas marreveshjeve me shkrim mbi projektin, vleren dhe cmimet per ndryshimet e kerkuara.

7.8. Nenkontraktori eshte pergjegjes ne zbatimin me korrektesi te rregullave te sigurimit teknik dhe ruajtjes te ambjentit specifikisht, siguria per per punetoret dhe pajisjet e tyre ,kontrolli ne hyrje te objektit, kushtet sanitare dhe pastrimi i vendit te punes ,ndihma mjekesore dhe mbrojtja nga zjarri, ne baze te dispozitave ligjore ne fuqi.

7.9. Nenkontraktori do te informoje me shkrim rreth problemeve qe mund te dalin gjate procesit te punes dhe porosites do te jape shpjegimet e kerkuara brenda nje afati te arsyeshem.

7.10. Te gjitha te punesuarit e nenkontraktorit duhet te jene te siguruar ne respektim te te gjitha dispozitave ligjore dhe vendimeve apo udhezimeve ne fuqi.

Nenkontraktori duhet ti dorezoje kontraktorit cdo muaj listen e punonjesve te siguruar ne organet shtetore dhe perditesimin e ndryshimeve te kryera brenda dites.

Ne raste se kontraktori gjobitet nga ana e organeve fiskale per shkak te mungesave ne raportimin fiskal nga ana e nenkontraktorit gjoba do te zbritet nga vlera e punimeve te faturuara nga nenkontraktori.

Nenkontraktori do te mbaje pergjegjesi direkte penale dhe do te ndiqet penalisht per cdo punetor qe aksidentohet ne pune dhe nuk eshte i siguruar prane organeve perkatese ne respektim te legjislacionit ne fuqi.

Kontraktori Arifaj sh.p.k. do te jete i pejashtuar nga cdo pergjegjesi civile dhe penale qe vjen si pasoje e mos raportimit te punetoreve nga ana e nenkontraktorit.

7.11. Nenkontraktori eshte i detyruar te mbaje ne objekt ditarin e punimeve simbas kerkesave ligjore per te dhe kontraktori ka te drejte ta lexoje kete ditar.

Neni 8. Te drejtat dhe detyrimet e kontraktorit

8.1. Kontraktori eshte i detyruar t'i jape nenkontraktorit te gjitha dokumentacionin e nevojshem te knik dhe projektin apo projektin e zbatimit, per realizimin e porosise objekt i kesaj kontrate.

8.2. Kontraktori duhet te paguaje nenkontraktorin konform rregullimeve ne kete kontrate.

8.3 Kontraktori mund te caktoj nje ing. supervizor per te mbikqyrur punimet.

8.4. Kontraktori duhet te siguroje mbeshtetjen teknike te kerkuar nga nenkontraktori.


8.5. Kontraktori merr persiper te siguroje ambientin e duhur ne objekt per realizimin e siper marrjes.

8.6. . Kontraktori ka te drejte te ushtroje kontroll te cilesise se investimit si edhe detyrimet qe ka ne nkontraktori te parashikuara ne nenin 6 te kesaj kontrate.

8.7. Kontraktori ka te drejte t'i kerkoje nenkontraktorit cdo lloj informacioni per te kontrolluar ecurine e punimeve, por nuk eshte i autorizuar te instruktoj apo urdheroj drejt per se drejti inxhinieret, furnizuesit, apo te punesuarit e nenkontraktorit.

8.8. Kontraktori eshte i detyruar te siguroje punim te qete dhe nje vend magazinimi per pajisjet dhe veglat e punes sipas udhezimeve te nenkontraktorit.

8.9 Kontraktori eshte i detyruar te kryeje pagesat ne afatin e caktuar, ne rast te kundert ndaj tij



do te aplikohen penalitete mbeshtetur ne rregullat e pergjithshme te zbatueshme ne treg.

Neni 9. Perfundimi i punimeve dhe kolaudimi i tyre

9.1. Me perfundimin e punimeve, nenkontraktori njofton kontraktorin dhe mbikqyresin se objekti eshte perfunduar plotesisht pa asnje te mete dhe eshte i gatshem per tu kolauduar dhe marre ne dorezim.

9.2. Nese kontraktori, gjate periudhes se kolaudimit dhe marrjes ne dorezim te objektit, konstaton te meta apo mangesi te cdo natyre qofshin ato, mban proces-verbal te vecante duke caktuar nje afat per riparimin e te metave dhe plotesimin e mangesive nga nenkontraktori me shpenzimet e ketij te fundit.

Neni 10. Garancite dhe Pergjegjësia per defektet

10.1. Nenkontraktori garanton cilesine e te gjitha punimeve sipas rregullave te ndertimit te njohura boterisht dhe projektit.

10.2. Kontraktori mund te njoftoje nenkontraktorin per cdo deformim te vepres brenda nje dite nga zbulimi i tyre. Ne te kundert, ai humbet kete te drejte (dekadence). Njoftimi nuk eshte i domosdoshem kur nenkontraktori i ka njohur e pranuar deformimet ose kur i ka fshehur ato qellimisht.

10.3. Nenkontraktori eliminon defektet e njoftuara brenda 10 diteve nga data e njoftimit.

10.4. Garancia e difekteve do te jete 5%e vleres se kontrates qe do te mbahet nga cdo situacion nenkontraktorit si garanci per cilesine e punimeve, shume e cila do te paguhet mbas perfundimit te periudhes se garancise se punimeve, duke mare parasysh edhe sanksionet e parashikuara ne kete kontrate.

10.5. Periudha e garancise per difektet eshte 24 muaj kalendarik.

10.6. Deshtimi per te korigjuar defektin brenda 10 diteve pune perben shkak per zgjidhjen e kontrates.

10.7. Ne qofte se nenkontraktori nuk korigjon defektet e konstatuara ne periudhen e garancise se defekteve brenda afatit te percaktuar, kontraktori do te vleresoje koston e korigjimit te defektit dhe nenkontraktori do te paguaje kete shume se bashku me nje gjobe te vecante, e cila do te jete 0.02% te vleres se kontraktuar per cdo dite vonese. Kontraktori do ta mbaje kete shume duke e zbritur nga garancia e punimeve e cila eshte mbajtur progresivisht ne situacione.

10.8. Nese ne perfundimin e periudhes se garancise nenkontraktori nuk ka korigjuar defektet e konstatuara, kontraktori zbret nga garancia deri ne konfiskimin e krejt garancise se punimeve.

Neni 11. Zgjidhja e kontrates

Palet mund te zgjidhin kontraten ne perputhje me rregullimet e percaktuara ne nenet 850-876 te Kodit Civil.


Neni 12. Mosmarreveshjet

12.1. Palet ne kete kontrate do te zgjidhin cdo lloj mosmarreveshje midis tyre me mirekuptim. Per zgjidhjen me mirekuptim te tyre palet do t'i drejtohen per ndihme te kualifikuar avokateve te tyre.

12.2. Ne rast deshtimi te ndermjetesimit, kompetente per zgjidhjen e mosmarreveshjeve eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 13. Korrespondenca midis paleve

Te gjithë komunikimet dhe urdherat e nevojshem per zbatimin e kesaj kontrate do te behen me shkrim mes paleve. Menyra e komunikimit do te jete me poste, fax ose e-mail.



Nenkontraktori : "Pepa Grup"
Perfaqesuesi : Urim PEPA
Adresa : Kashar Tirane
Cel. : +355(0) 0662090990
E-mail :
Kontraktori : "ARIFAJ" sh.p.k.
Perfaqesuesi : Rezarta Bokciu
Adresa : Rruga Urani Pano, Tirane
E-mail : arifaj_shpk@yahoo.com
Cel. : +355 (0) 68 20 20 407

Te gjitha verejtjet dhe udhezimet apo propozimet me shkrim gjate zbatimit te kesaj kontrate duhet te protokollohen ne nje dosje te vecante per korrespondencen midis paleve.

Detyrimet dhe te drejtat qe burojne nga kjo kontrate fillojne efektet e tyre nga momenti i nenshkrimit te saj.

Kontrata perpilohet ne 3 (tre) shtypshkrime te barasvlefshme, ne gjuhen shqipe, me permbajtje te njejte ligjore.

Kontraktori
"ARIFAJ" sh.p.k
Administrator
Rezarta BOKÇIU



Nenkontraktori
"Pepa Grup"

